



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
УСТАВНИ СУД  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 16 korrik 2012  
Nr. ref.: RK/280/12

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI24/12**

Parashtruesi

**Alban Kastrati**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës,  
Pkl. nr. 1/2010, të 3 dhjetorit 2010**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është paraqitur nga z. Alban Kastrati (Parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga z. Nysret Mjeku, avokat nga Prishtina. Sidoqoftë, më 29 maj 2012, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi Gjykatës dokumente shtesë, me ç'rast autorizimi i z. Nysret Mjekut u anulua ndërsa z. Ibrahim Z. Dobruna, avokat nga Prishtina, u emërua për ta përfaqësuar parashtruesin e kërkesës.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl. nr. 1/2010, të 3 dhjetorit 2010, i cili i ishte dorëzuar më 29 dhjetor 2010.

## **Objekti i çështjes**

3. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i sipërpërmendur i shkel të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), domethënë të nenit 3 [Barazia para Ligjit], nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] si dhe nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokollet e saj (në tekstin e mëtejme: "KEDNJ").

## **Baza juridike**

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 22 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Më 7 mars 2012, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 8 mars 2012, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Enver Hasani dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 11 maj 2012, Gjykata kërkoi sqarime shtesë nga parashtruesi i kërkesës, për ta informuar nëse parashtruesi e kishte referuar kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese apo në Gjykatën Supreme dhe të sqarojë cilat janë dispozitat kushtetuese të cilat pretendohen të jenë shkelur nga Gjykata Supreme.
8. Më 22 maj 2012 parashtruesi i kërkesës u përgjigj duke e informuar se kërkesa i ishte referuar Gjykatës Kushtetuese dhe dispozita kushtetuese e cila pretendohet se është shkelur nga Gjykata Supreme është neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] i Kushtetutës .
9. Më 29 maj 2012, parashtruesi i kërkesës paraqiti dokumente shtesë në Gjykatë, në mes të cilave edhe anulimin e autorizimit për Z. Nysret Mjeku, avokat nga Prishtina, i cili fillimisht kishte paraqitur kërkesën.
10. Më 6 qershor 2012, Gjykata ia komunikoi kërkesën Gjykatës Supreme dhe Prokurorit Publik të Shtetit.
11. Më 13 qershor 2012, Gjykata kërkoi sqarime shtesë nga parashtruesi i kërkesës, për ta informuar nëse parashtruesi e kishte autorizuar të atin apo avokatin të paraqet kërkesë në Gjykatën Kushtetuese.

12. Më 14 qershor 2012, Gjykata kërkoi nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë vërtetimin se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme Pkl. nr. 1/2010 i 3 dhjetorit 2010 i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës.
13. Më 18 qershor 2012, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin për Z. Ibrahim Dobruna të nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës.
14. Më 10 korrik 2012, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit Raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhje e fakteve**

15. Më 29 qershor 2007, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Vendimi P. nr. 667/2006) e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale. Parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatën Supreme ankesë kundër këtij vendimi.
16. Më 11 qershor 2008, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Ap. nr. 488/07) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut. Parashtruesi i kërkesës paraqiti në një kolegji tjetër shqyrtues në Gjykatën Supreme ankesë kundër këtij vendimi.
17. Më 11 qershor 2009, Gjykata Supreme (Aktgjykimi API. nr. 5/08) e hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të 11 qershorit 2008. Parashtruesi i kërkesës e paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër aktgjyqimeve të Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës Supreme .
18. Më 3 dhjetor 2010, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pkl. nr. 1/2010) e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

### **Pretendimet e parashtruesit**

19. Parashtruesi pretendon se me aktgjykimet e nxjerra janë bërë shkelje esenciale të dispozitave të ligjit të procedurës penale dhe të ligjit penal.
20. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se aktgjykimet “nuk përbëjnë fakte që do të vërtetonin veçoritë e veprës penale, në bazë të cilave fakte, gjykatat do të mbështesnin gjykimin e tyre.”
21. Për më tepër, Gjykata e instancës së parë dhe Gjykata Supreme gjoja nuk e kishin bërë një analizë të veprës penale dhe aktgjykimet janë në kundërshtim me deklaratat e të pandehurve, dëshmitarëve dhe dokumenteve të tjera të dosjes së lëndës.
22. Prandaj, parashtruesi i kërkesës konsideron se Gjykata ka shkelur nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] e KEDNJ.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

23. Gjykata, vëren se, në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, duhet që së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret

procedurale për pranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, siç specifikohen më tutje në Ligj dhe në Rregulloren e punës të Gjykatës.

24. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se ajo mund të vendosë në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës, nëse parashtruesi i kërkesës tregon se ai/ajo e ka paraqitur kërkesën “brenda afatit prej katër (4) muajve [...] që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor”, në pajtim me nenin 49 të Ligjit.
25. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 1/2010, është lëshuar më 3 dhjetor 2010 dhe i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 29 dhjetor 2010, ndërsa parashtruesi i kërkesës e paraqiti kërkesën në Gjykatë më 7 mars 2012, d.m.th. më tepër se 4 muaj nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi i Gjykatës Supreme.
26. Për më tepër, rregulli 36 1 (c) i Rregullores së punës përcakton se: “*Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar.*”
27. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e fakteve apo ligjit (ligjshmëria) gjoja të bëra nga Gjykata Supreme, nëse dhe deri më tani ato mund t’i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Kushtetuta (kushtetutshmëria). Në këtë mënyrë, Gjykata kur i shqyrton vendimet e marra nga gjykatat e rregullta nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt. Është detyrë e gjykatave të rregullta për të interpretuar dhe zbatuar rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz v. Spain [GC], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
28. Me pak fjalë, Gjykata mundet vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në atë mënyrë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë tyre, janë kryer në atë mënyrë që parashtruesi ka pasur një gjykim të drejtë (shih në mes autoriteteve të tjera, Raporti i Komisionit Evropian mbi të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards v. Mbretërisë së Bashkuar, App. Nr. 13071/87, i miratuar më 10 qershor 1991).
29. Parashtruesi gjithashtu thjesht kundërshton nëse Gjykata Supreme kishte zbatuar në tërësi ligjin në fuqi dhe nuk pajtohet me të gjeturat faktike të Gjykatës në lidhje me këtë rast.
30. Në fakt, parashtruesi nuk kishte argumentuar pohimin mbi bazën kushtetuese dhe nuk kishte ofruar prova, se të drejtat dhe liritë e tij janë shkelur nga autoriteti publik. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të përfundojë se procedurat përkatëse kanë qenë të padrejta apo të prishura nga arbitrariteti (shih *mutatis mutandis*, Shub v. Lithuania, GJEDNJ Vendimi për pranueshmëri të kërkesës Nr. 17064/06 i 30 qershorit 2009).
31. Prandaj, parashtruesi nuk ka treguar pse dhe si Gjykata Supreme i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.
32. Përgjithësisht, pason se kërkesa është e papranueshme, për shkak se është e paafatshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe edhe nëse do të ishte brenda afatit është qartazi e pabazuar në pajtim me rregullin 36 (1.c) të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1c) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 10 korrik 2012, njëzëri

### VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari Raportues**



Almiro Rodrigues

**Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. Dr. Enver Hasani